



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

**A nr. 984/2013**

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), dega në Prishtinë, paraqitur kundër Komisionit Komunal Zgjedhor (KKZ), dega në Lipjan për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor në ruandin e dytë të zgjedhjeve lokale, në seancën e panelit të mbajtur me 04.12.2013, mori këtë:

### **VENDIM**

**Refuzohet** si e pabazuar ankesa e Institutit Demokratik i Kosovës (KDI), dega në Prishtinë.

### **Arsyetim**

PZAP-i, ka pranuar një ankesë më datë 02.12.2013, nga Institutit Demokratik i Kosovës (KDI) dega në Prishtinë, në të cilën ka pretenduar se në Qendrën e Votimit (QV) 1304e në fshatin Shalë të Komunës së Lipjanit në Vendvotimet nr. 01 dhe 02, komisioni ka lejuar votimin e qytetarëve me dokumente të cilat nuk lejohet votimi. 1. Rasti i parë votim me çertifikatë të lindjes, 2. Indeks të lindjes, 2. Indeks të Universitetit, Dokument i policisë si deklaratë e humbjes së dokumentit.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën gjeti se:

### **Ankesa është e pabazuar**

Nga dëshmit e ofruara si provë të cilat gjenden në shkresat e lëndës nuk ka prova të mjaftueshme që do t'i bënim të besueshme pretendimet ankimore të ankuesit KDI ndaj Komisionit të vendvotimit (QV) nr.1304e në Komunën e Lipjanit. Mirëpo pretendimet ankimore të kësaj natyre janë të pabazuara, pasi që nuk janë të përgjithshme dhe janë të paqarta për të cilat nuk mund të vërtetohen.

PZAP-i konstatoi se pretendimet ankimore nuk qëndrojnë sepse nuk ka ofruar asnjë provë dhe dëshmi bindëse që është bërë një shkelje e tillë, prandaj në kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së, si dhe neni 3.6 pika c) të Rregullores së PZAP-I lidhur me ankesën e lartë përmendur u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia**

Anr. 984/2013 më datën 04.12.2013



***Këshillë Juridike:*** Ndaj këtij vendimi mund të paraqitni ankesë në Gjykatën Supreme të Republikës së Kosovës brenda 24 ( njëzetekatër) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.